



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/03  
Datë: 02.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 33 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Raporti i Vlerësimit të Përshtatshmërisë së Sistemit të Financimit të Komunave për vitin 2020.
2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe ministrinë e linjës për zbatimin e rekomandimeve nga ky Raport.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/03  
Datë: 02.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 62 pika 4 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa për miratimin e Buxhetit për Komunën e Mitrovicës pas aprovimit të Buxhetit për vitin 2021 nga Kuvendi Komunal i Mitrovicës, me datë 04.02.2021.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin së bashku me tabelat ta procedojë në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Komuna e Mitrovicës për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/03  
Datë: 02.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2021, merr këtë:


**V E N D I M**

1. Z. Xhelal Sveçla, emërohet Koordinator Nacional për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftimin e Terrorizmit.
2. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara si më poshtë:
  - 2.1. Përgjegjës për koordinimin, bashkërendimin, monitorimin dhe raportimin e implementimit të politikave, aktiviteteve dhe veprimeve lidhur me çështjet e luftimit të terrorizmit dhe kundër ekstremizmit të dhunshëm;
  - 2.2. Këshillon Kryeministrin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me luftimin e terrorizmit, dhe ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin;
  - 2.3. Koordinon aktivitetet e të gjitha institucioneve relevante në çështjet e luftimit të terrorizmit dhe masave kundër ekstremizmit të dhunshëm;
  - 2.4. Koordinon, monitoron dhe mbikëqyrë zbatimin e dokumenteve strategjike të luftimit të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm;
  - 2.5. Pranon raporte informuese nga institucionet relevante, me qëllim të përgatitjes së dokumenteve strategjike analitike lidhur me luftimin e terrorizmit dhe ekstremizmin e dhunshëm;
  - 2.6. Është përgjegjës dhe pikë kontakti ndërinstitucional dhe ndërkombëtar për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm, duke përfshirë koordinimin e organizimeve, donacioneve dhe projekteve vendore dhe ndërkombëtare;
  - 2.7. Koordinon të gjitha raportimet rreth përgjegjësisë dhe obligimeve të institucioneve të Republikës së Kosovës në nismat rajonale dhe ndërkombëtare që kanë të bëjnë me çështjen e luftimit të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.



3. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë deri në një vendim tjetër të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
4. Obligohet Koordinator Nacional për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftimin e Terrorizmit dhe institucionet relevante për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/03  
Datë: 02.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 16 paragrafi 2 të Ligjit për Partneritet Publiko-Privat Nr. 04/L-045, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Emërohet Komiteti për Partneritet Publiko-Privat, në këtë përbërje të anëtarëve të përhershëm, si në vijim:
  - 1.1. Hekuran Murati, Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve, kryesues;
  - 1.2. Rozeta Hajdari, Ministre e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, anëtare;
  - 1.3. Liburn Aliu, Ministër i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, anëtar;
  - 1.4. Artane Rizvanolli, Ministre e Ekonomisë, anëtare dhe
  - 1.5. Elbert Krasniqi, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar.
2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 02/07 i datës 22.06.2020 për emërimin e anëtarëve të Komitetit për Partneritet Publiko-Privat.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 05/03  
Datë: 02.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës zbaton sanksionet e vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian përmes Vendimit (CFSP) 2021/481 e Këshillit të Bashkimit Evropian, të datës 22 mars 2021, i cili ndryshon dhe plotëson Vendimin (CFSP) 2020/1999 në lidhje me masat kufizuese kundër shkeljeve serioze të të drejtave të njeriut dhe abuzimeve, të datës 7 dhjetor 2020, ndaj katër (4) personave dhe një (1) entiteti kinez, të përfshirë në abuzime dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, në Xinjiang.
2. Sanksionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të përcaktuar si në pikën 1, të këtij vendimi, janë të listuara në shtojcën Nr. 1, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Zbatimi i sanksioneve ndërkombëtare të përcaktuara me këtë vendim vlen deri me datën e përcaktuar në Vendimin (CFSP) 2020/1999 në lidhje me masat kufizuese kundër shkeljeve serioze të të drejtave të njeriut dhe abuzimeve, të datës 7 dhjetor 2020, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin (CFSP) 2021/481 e Këshillit të Bashkimit Evropian, të datës 22 mars 2021.
4. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/03  
Datë: 02.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 3 të Ligjit për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Drejtësisë për iniciimin e procedurave ligjore për përzgjedhjen e ekspertit financiar i cili do të përpilojë ekspertizën financiare për rastin ICC Case 25183/HBH Devolli, të kërkuar nga Tribunali i Arbitrazhit Ndërkombëtar.
2. Autorizohet Ministria e Drejtësisë që, për shkak të natyrës urgjente të çështjes në arbitrazh, të ushtrojë procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës për të përzgjedhur ekspertin si nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Obligohet Ministria e Drejtësisë, që ti zhvillojë procedurat përkatëse me qëllim të zbatimit të obligimeve që rrjedhin nga pika 1. e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë